



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.215/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 29.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.215/2025 e datës 27.01.2025, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 27.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 26 janar 2025, PDK ka vërejtur se në profilin e kandidati për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, z. Nasuf Bejta, ka të publikuar një fotografi në rrjetin social facebook, në ambientet e Spitalit të Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri" në Mitrovicë, ambiente të cilat i biri i tij - mbështetësi, z. Artan Bejta ka shfrytëzuar si person i cili mban pozitë publike, me qëllim të përfitimit të votave. Konkretisht, mbështetësi z. Artan Bejta, shpërndarjen e fotografisë e ka bërë me tekst shoqërues, ku ndër të tjerash ka shkruar "*VVushtrri, VVetëvendosje, VVazhdojmë! #LVV 1 18, #Nasuf Bejta 89*". Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se mbështetësi në fialë, foton e ka publikuar nga ambientet që i bartë si person me pozitë publike, respektivisht si specialist i ortopedisë në Spitalin e Përgjithshëm "Dr. Sami Haxhibeqiri" në Mitrovicë, me qëllim të promovimit të numrit në listën me të cilën kandidon për deputet z. Nasuf Bejta, gjithashtu kjo foto vazhdon të jetë aktive edhe më tutje, në profilin e kandidatit për deputet z. Nasuf Bejta si dhe mbështetësit z. Artan Bejta. Për qëllime të argumentimit të afatshmërisë së

ankesës, PDK, njoftoj PZAP-në se shpërndarja e fotografisë në rrjetin social facebook nga z. Nasuf Bejta dhe z. Artan Bejta është bërë më 26 janar 2025, në ora 00:21/h.

Gjithashtu parashtruesi i ankesës ka theksuar se në bazë të pretendimeve të elaboruara në ankesë dhe duke marrë për bazë shkeljen e rregullave zgjedhore nga ana e z. Nasuf Bejta dhe mbështetësit z. Artan Bejta, nga PZAP ka kërkuar që të nxjerrë vendim me të cilin do të aprovojë si të bazuar ankesën e PDK-së dhe ndaj subjektit politik LVV, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, t'i shqiptoj dënim me gjobë.

Si provë ka bashkangjitur CD dhe fotografi një link,
<https://www.facebook.com/artan.bejta/posts/pfbid02k8CCN3SEqkB04zb5P5K4Drr9ëKr70SdxEtVptmLb212ZdZEavNul<7qmAtB0Uayzgl>

Më datë 27.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 28.01.2025 në ora 15:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 28.01.2025, të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje e kundërshtojnë në tërësi ankesën e parashtruar nga PDK, për shkak se nga përshkrimi i provave të bashkangjitura, si fotot e kandidatit me djalin e tij, biografia në rrjetin social facebook ku përmendet vendi i punës dhe një postim jo relevant në facebook, tentohet të paraqitet sikurse kjo ngjarje ka ndodhur në ambientet e Spitalit Publik të Mitrovicës, "Dr. Sami Haxhibeqiri". Më tutje në përgjigje në ankesë është theksuar se, për ne kjo përbën një lajthitje në fakt (error in factis), nga ana e parashtruesit kur pretendojnë se kjo foto është shkrepur në ambientet e spitalit publik në Mitrovicë, sepse e njëjta është shkrepur në Ordinancën Private të z. Artan Bejta, si dhe përmes përgjigjes në ankesë ka kërkuar që ankesa të hedhet si e pa bazuar.

Si provë ka bashkangjitur foto në vendin e njëjtë, licenca e lëshuar nga e drejta publike, lidhur me veprimtarinë "Ambulancë Specialistike e Pediatriisë", me themelues Artan (Nasuf) Bejta dhe Certifikatën e Regjistrimit të biznesit "Ortopediatria" SH.P.K.

PZAP-i, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga video dhe fotografitë të cilat paraqitësi i ka bashkangjitur si dëshmi ankesës, nuk mund të vërtetohet se nga ana e Subjektit Politik LVV, është bërë shkelje e nenit 36 paragrafi 1 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *"personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyre apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje"*


Nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, vërehet se është realizuar një foto e kandidatit për deputet z. Nasuf Bejta nga LVV, me djalin e tij z. Artan Bejta e publikuar në rrjetin social facebook por nuk është argumentuar në asnjë moment në mënyrë të qartë dhe

bindëse se fotoja është realizuar në ambientet e Spitalit Publik të Mitrovicës, "Dr. Sami Haxhibeqiri", ashtu siç pretendohet nga pala ankuese, pasi që nga të gjitha fotografitë e dorëzuara si provë në përgjigje në ankesë vërtetohet se fotoja është realizuar në ambientet e Ordinancës Private "Ortopediatra" SH.P.K, me themelues Artan (Nasuf) Bejta.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, dhe si të tilla të njëjtat i refuzoi si të pabazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.215/2025 më datën 29.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.